

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Shërbim për larje pusesh

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
42716110(paisje larje)

- **VLERA E FONDIT LIMIT: 1 150 000(Një milion njëqind pesëdhjetë) Lekë PA TVSH**

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

### 2.2 Aftësitë teknike, ekonomike dhe profesionale:

- ❖ 2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros (vertetim nga administrate tatimore) për te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022) që është 40% i fondit të parashikuar të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- ❖ 2.2.2 Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së më parshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklarua ranë organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kopje te vërtetuar te bilanceve, te audituara nga ekspertet kontabël te licencuar, te konfirmuara nga autoritetet përkatëset e Administratës Tatimore, te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022) ku te pakten ne dy bilancet e nje pasnjeshme, nuk ka raport negative ndermjet aktivitet dhe pasivitet. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetem ne rastet kur jane ne kushtet e percaktuara nga neni 41, germa ‘c’ e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (indryshuar)”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

---

---

## 2.3 Specifikimet teknike dhe profesionale

### 2.3.1 Specifikimi i Materialeve: Specifikimet Teknike të Autosondës:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **autosondë copë 1(një)**, me specifikime teknike sivejton:

1. Autosonda të ketë pompë qarkullimi dhe pompë ajri
2. Kapacitet të mjaftueshëm ngritës **jo më pak se 20 ton**
3. Sonda duhet të jetë Hidraulike me rrotullim
4. Të ketë në paisje të makinerisë një **kompresor jo më pak se 22 atm**

### 2.3.2 Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Puset të cilat do të nënshtrohen procesit të pastrimit, specifika e tyre është që pjesa më e madhe e tyre, janë të vjetër dhe kanë një kohë të gjatë shfrytëzimi.

Për pastrimin e tyre kërkohet teknikë e lartë me një staf të specializuar dhe me paisje e makineri komplet, për ti përballuar të gjitha proceset gjatë manovrimit të pastrimit.

Në realizimin e detyrës së ngarkuar për pastrimin e këtyre puseve është planifikuar të kryehen proceset si: Trasporti i Sondës dhe gjithë bazës materiale te nevojshme: si Tubot pomp-kompresor, depozitat e ujit, depozitat e solucionit të përpunimit e tapës dhe aktivizimit të shtresës.

Vendosja e sondës në stacionin e pikës së pusit,

Ulje e tubove me manovër poshtë me qarkullim me presion përpastrim.

Pastrim pusi me presion për zhbllokimin e shtresës së ujit dhe pastrimin e pusit.

Presimi i kollonës me Kompresor dhe ngritjen e tubove lartë- poshtë deri në stabilizim.

### 2.3.3 Shërbimet që kërkohen:

Pastrim pusi me kompresor pompim me presion Manover larte

Shënim: Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Lushnje , fillon me nënshkrimin e kontratës me OE dhe përfundon me afat 1-vjekar.

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Pastrimi i Puseve që kanë si specifike se janë të vjetër dhe kanë një kohë të gjatë shfrytëzimi.

Qëllimi i shërbimit të pastrimit të tyre është për një efijencë sa më madhe pune.

## **Detyrat:**

Trasport makinerie dhe Furnizim baze materiale per procesin e pastrimit, sipas distances ne km  
Pastrim pusi me kompresor pompim me presion Manover larte

**Shpërndarja: 1.Pusi Libofsh 2. Pusi Gogolas 3. Pusi Konjat 4. Pusi Garunjas 5. Pusi Allprenaj 6. Pusi Kupas 7. Pusi Hysgjokaj 8. Pusi Bicakaj**  
**Sipas vendndodhjes së puseve**

## **2.4 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **2.4.1 Ofertuesi duhet të paraqesë:**

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, kërkojmë:

Licensa profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates:

-Licensa : N.S.20 – Klasifikimi “A”.

Fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit  
Numri mesatar i punetoreve te siguruar, te jete jo me i vogel se 5 persona per muaj, duke përfshirë edhe stafin teknik të përhershëm të punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik (22 ditë pune në muaj)

Kjo pike dokumentohet me vertetim te leshuar nga Drejtorite Rajonale te tatimeve (Deget e Tatimeve) ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vulë elektronike

Listëpagesën e muajit te fundit.

Mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) autosondë në pronësi të tij ose të marrëme qira, e vërtetuar me dokumentat përkatëse, me kohëzgjatje sa periudha e vlefshmërisë së kontratës.

Sonda duhet të jetë e pajisur me leje qarkullimi, kolaudimi, siguracioni.

Për të provuar paisjen me kompresor jo më pak se 22 atm (në qoftë se kjo nuk është e cilësuar në certifikimin e sondës), kompresori duhet të jetë i instaluar fizikisht dhe vërtetësia e orgjinalitetit, të dëshmohet me foto të sondës tek pjesa ku është instaluar kompresori.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.



Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

---

**Serxhjo Zylali**

**Njesia Prokurimit**

**Klajdi Myzeqari**

**Fatime Tahiraj**